



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:111321

Datë: 24.06.2022

Numri i dokumentit: 03169682

APS.nr.6/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti Special në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Kreshnik Radoniqi -Kryetari i kolegjit, Vaton Durguti dhe Tomislav Petrovic-anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.S. nga fsh. ..., Komuna e Fushë Kosovës, me vendqëndrim në Gjermani dhe M.S. nga Prishtina, për shkak të veprës penale, si bashkëkryerës, Shpërlarja e parasë nga neni 308 dhe nenit 56 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit mbi parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.37/17 të datës 20.01.2022, të akuzuarve F.S.-av.Faton Qirezi dhe M.S.-av.Florent Latifaj, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.849/20 të datës 30.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 23.06.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe e mbrojtësve e të akuzuarve F.S.-av.Faton Qirezi dhe M.S.-av.Florent Latifaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.849/20 i datës 30.11.2021, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.849/20 të datës 30.11.2021 F. dhe M.S. janë shpallë fajtor për shkak të veprës penale, si bashkëkryerës, Shpërlarja e parasë nga neni 308 dhe nenit 56 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit mbi Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe janë dënuar secili veç e veç, me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të njëjtit në periudhën kohore prej 2 (dy) vite nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënimi me gjobë secilit veç e veç në shumë prej 5.000

euro (pesëmijë euro) i cili dënim do të paguhet në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se 3 muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në bazë të nenin 46 të KPRK-së, po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet nga të pandehurit, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg duke i caktuar nga një ditë burgim për 20 euro të gjobës.

Në vështrim të nenit 62 par.1 dhe par.2 pika 2.7 të KPRK-së të pandehurve ju cakton dënimin plotësues ashtu që të pandehurve F.S. dhe M.S. i konfiskohet shuma e parave në vlerë prej 946,820.84 euro, si dhe secilit veç e veç do t'ju konfiskohet shumat e parave në vlerë nga 3,000 euro, të cilat para i kanë tërhequr nga xhirollogaria e firmës "N..." me seli në Kosovë.

Obligohen të pandehurit F.S. dhe M.S. që të paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç nga 200 euro si dhe për fondin për mbrojtjen e viktimave të krimit secili me nga 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se 3 muaj, pas plotfuqishmërisë së të këtij aktgjykimi.

Në afat ligjor ankesë kanë paraqitur;

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penalë me propozim që Gjkata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarve F.S. dhe M.S. ti shqiptoj dënimin më të rënd me burg efektiv dhe gjobë deri në tre herë më të lartë sesa pasuria e konfiskuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.S.-av.Faton Qirezi, për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjkata e Apelit ta aprovoj ankesën në tërësi duke marrë aktgjykim lirues për mungesë provash.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.S.- av.Florent Latifaj, për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjkata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës ta liroj të mbrojturin e tij nga përgjegjësia penale ngase në veprimet e tij nuk përmbushet asnjë element i veprës penale për të cilin është shpallur fajtor, ose eventualisht të kthej çështjen në rigjykim me rekomandimet të qarta për Gjykatën e shkallës së parë.

Prokuroria e Apelit të Kosovës në Prishtinë me shkresën PPA/I nr.109/22 të datës 22.02.2022, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovë ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe të akuzuarve ti shqiptohet dënimi më gjobë më të lartë me burg efektiv, ndërsa ankesat e mbrojtësve e të akuzuarve F.S.-av. Faton Qirezi dhe M.S.-av.Florent Sopjani , të refuzohe si të pabazuara.

Gjkata e Apelit mbajti seancën e kolegjit më datë 21.06.2022 konform dispozitës të nenit 390 par.1 të KPPRK-së, për të cilën seancë nuk njoftoi palët meqenëse nuk është e obligueshme konfrom kësaj dispozite ngase nuk është shqiptuar dënimi me burgim ndaj të akuzuarve, por dënim alternativ-dënim me kusht dhe as që ka pasur propozim në ankesë nga palët për tu ftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar si dhe pretendimet ankimore, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë dhe mendimin e Prokurorisë së Apelit , gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ajo e mbrojtësve e të akuzuarve F.S.-av.Faton Qirezi dhe M.S.-av.Florent Latifaj, janë të **pabazuara**.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit **F.S.-av.Faton Qirezi**, në ankesë pretendon aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 e tutje neni 370 par.7 ngase gjykata është dashur që të paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, gjithashtu në mënyrë të veçantë të vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, ndërsa dështimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me këto pika paraqet shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit **M.S.-av. Florent Latifaj**, në ankesë duke cituar nenin 384 par.1 pika 1.12 e tuje neni 370 par.7 të KPPRK-ës, pretendon se duke marrë për bazë definimin e veprës penale të shpërlarjes së parasë e më pastaj dispozitën penale e cila i referohet shkeljeve esenciale duhet të theksomë se gjykata në tersi ka dështuar të përmbush detyrimin e përcaktuar nga neni 370 par.7 duke përgjithësuar veprimet dhe duke mos ndarë asnjë veprim të akuzuarit ku është pasqyruar inkriminimi i shpërlarjes së parave. Dispozitivi i aktakuzës i përshkruar edhe në aktgjykim është në kundërtënie me vetveten, ngase në tër përshkrimin flet për transferin e parave në llogari bankare, gjegjësisht nga bankat ndërkombëtare në Kosovë dhe këto transfere më pastaj i konsideron se janë para të pista duke mos ofruar asnjë dëshmi të vetme se si qenkan këto para të pista dhe nga e kanë prejardhjen. Prokurori ngatërron faktet duke konsideruar se mbase kanë ndarë 25% të fitimit atëherë edhe përgjegjësia është e njejtë, gjë që nuk qëndron pasi mundet të kesh përgjegjësi të kufizuar dhe sërish të jesh partner në një firmë në mënyrë të barabartë. Duhet cekur se parat e pista mund të konsiderohen vetëm ato që rrjedhin si fitim i veprës penale dhe jo vetëm në bazë të konstatimit se janë të tilla pa ofruar asnjë argument ligjor. Për më tepër duke anashkaluar faktin vendimtar se në çdo vend të botës deponimi i shumës së madhe të parave kërkon arsyetim, njëlloj siç është rregulluar edhe me legjislacionin vendor. Gjersa parat kanë rrjedhur nga një bankë ndërkombëtare tek një bankë vendore në Kosovë, atëherë duhet të saktësohet nga Prokurori por edhe nga Gjykata në bazë të cilave njohurive kanë ardhur në përfundim se parat e transferuara janë para të pista dhe se kanë për qëllim të pastrohen në Kosovë. Aktgjykimi në përmbajtjen e saj ka përshkrim të dispozitivit, dëshmime dhe fjalëve përfundimtare si dhe përshkrimi të ekspertizës financiare e cila thotë se është dëshmuar me prova të pakontestueshme nga organet gjyqësore të Danimarkës se bashkëpronarët kanë hapur disa kompani dhe biznese të vogla në vende të ndryshme duke bërë aktivisht transaksione ekonomiko financiare gjersa më tutje gjykata thekson se K.D.R. dhe i bashkëpandehuri tjetër është dënuar në Danimarkë për mashtrim me TVSH, gjegjësisht kanë bërë shmangie nga tatimi. Këtu ekziston një dallim esencial ngase shmangie nga tatimi dhe pastrimi i parave janë dy gjëra esencialisht të ndryshme. Gjersa shmangia, gjegjësisht ikja nga pagimi i tatimit, të cilit i referohet gjykata për të bashkëpandehurit K.R. dhe D.L. nënkupton se parat nuk janë të pista por nuk është paguar

tatimi për tërë shumën e parave të cilat i kanë poseduar në mënyrë të ligjshme të bashkëpandehurit, e ndërsa pastrimi i parave gjithmonë i referohet fitimit të parave nga vepra penale konkrete dhe tentimi për ti bërë pjesë e qarkullimit bankar, gjegjësisht pastrim i parave. Do të thotë dy gjëra krejtësisht të kundërta. Gjykata në aktgjykimin e saj së pari konstaton se ka ardhur në përfundim mbi shpalljen e aktgjykimit fajësues e më pastaj liston procesverbalet dhe të thënat e dëshmitarëve, ekspertit dhe provave materiale gjersa shton se argumentojë elementet kryesore të veprës penale siç edhe është kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë mënyrë është shprehur haptazi shkelja e dispozitës se cekur ku gjykata ka dështuar të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara në lidhje me pastrimin e parave.

Gjykata e Apelit, pasi analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në drejtim të pretendimeve ankimore gjeti se këto pretendimet janë të pabazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara sipas nenit 384 të KPPRK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, meqenëse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim ka dhënë arsye konkrete dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat i ka vërtetuar si dhe arsyet në të cilat është bazuar në rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike dhe përgjegjësisë penale e të akuzuarve, për të cilat arsye edhe kjo gjykatë i aprovon si të tilla.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtësit e të akuzuarit M.S.-av.Florent Latifaj se aktgjykimi në përmbajtjen e tij ka përshkrim të dispozitivit, dëshmime dhe fjalëve përfundimtare si dhe përshkrimin e ekspertizës financiare, për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, edhe pse në arsyetim ka paraqitur dëshmitë dhe fjalën përfundimtare, mirëpo të njëjtat i ka analizuar dhe vlerësuar konform nenit 361 të KPPRK-së, dhe mbi bazën e tyre ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe elementin subjektiv gjegjësisht të dashjes për veprën penale për të cilën i ka shpallur fajtor.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes të dallimit esencial të shmangies nga tatimi dhe pastrimit të parave, kjo gjykatë gjen se ky pretendim nuk është i bazuar meqenëse në këtë çështje penale nuk ishte objekt i shqyrtimit vepra penale shmangia nga tatimi, ku mbrojtësi tërheq vëmendjen në raport me veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, por për veprën penale të shpërlarjes së parave nga neni 308 të KPRK-së, e që i bashkëpandehuri-aksionar tjetër i kompanisë “N...” në Kosovë është shpallur fajtor për veprën penale, të shmangies së tatimit sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Frederiksberg në Danimarkë të datës 13.04.2015, e më pas në bashkëkryerje me të akuzuarit F. e M.S. kanë shpërlarë parat të cilat janë fituar nga aktiviteti kriminal gjegjësisht nga vepra penale, të cilën kjo gjykatë do të elaboroj në vazhdim të këtij aktgjykimi.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës përkitazi me shkeljen e ligjit penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.S.-av.Faton Qirezi, në ankesë pretendon se është shkel ligji penal nga par.1 pika 1.2 ngase ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale ngase gjatë shqyrtimeve në këtë proces penal është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk ka pasur dijeni se njëri nga personat me të cilin ka hyrë në biznes është i dënuar në shtetin e tij, ngase askush nuk kërkon

të kaluarën kriminale partnerëve biznesor, do të thotë mungon dijenia të cilën prokurori i rastit dëshiron t'ia m'vesh të mbrojturit të tij. Më tej ai i referohet përshkrimit të veprës penale të përshkruar në ligjin nr. 03/L-196, për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, duke theksuar se, në përshkrimin e veprimeve të F.S.t, ceket se ai dhe i afërmi i tij M.S. si dhe dy personat tjerë K.D.R. dhe D.S.L. kanë hapur një kompani këtu në Kosovë me emrin N... me qëllim për të bërë biznes dhe ky ka qenë vërtet qëllimi i tij në këtë rast. Duhet të kihet parasysh se këta persona që të katër kanë pranuar të hyjnë në bashkëpunim të ndërsjellë. Prokurori pretendon se parat e transferuara në Kosovë janë para të pista dhe se ato janë sjellë nga dy të pandehur tjerë e të cilët në vendet e tyre janë dënuar me veprën penale të shmangies nga tatimi, gjë e cila në fakt nuk e vërteton se paratë janë fituar nga veprimtaria kriminale, sepse shmangia nga tatimi ndodhë vetëm pasi paratë të jenë fituar, kurse nuk është vërtetuar kursesi se ato para janë fituar nga ndonjë vepër penale, sepse kategoria e “tatimit në fitim nga vepra penale” as që ekziston në asnjë sistem fiskal në botë. Paradoksi është i qartë, ngase nga shmangie tatimi dhe pastrimi i parave nuk janë të njëjta, përderisa shmangia konsiston në ikjen ose moslajmërimin e pasurisë së tërësishme për të paguar më pak tatim shtetit, për të cilën gjë është i dënuar partneri biznesor i të mbrojturit të tij, K.R., në vendin e tij kurse pastrimi do të thotë që parat kanë ardhur si rezultat i veprës penale (p.sh. në botë pastrohen paratë nga shitja e narkotikëve, armëve e gjë sendeve të palejuara dhe të cilat janë të dënueshme me të drejtat nacionale të secilit vend). Nëse K.R. është dënuar për shmangie nga tatimi dhe mashtrim në lidhje po me këtë shmangie tatimi në vendin e tij, kjo do të thotë se parat e tij nuk kanë qenë të pista asnjëherë por vetëm në vendin e tij nuk ka paguar tatim shtetit në përputhje me kërkesat ligjore në Danimarkë dhe se ata nuk ka pasur asnjë nevojë për të pastruar para. Më tej thekson se duhet pasur parasysh se përgjegjësia penale në të drejtën penale është gjithmonë individuale dhe se ajo nuk mund të nxirret nga veprimet e personit tjetër. Nëse nga disa bashkëpronar në një biznes njëri përfiton kundërligjshëm para, atëherë si mund të mbahet penalisht përgjegjës bashkëpronari tjetër dhe pikërisht kjo ka ndodhur te ky rast, ku i pandehuri F.S. mbahet përgjegjës për të veprimet e K.R. dhe D.L.. Në këtë rast prokurori i referohet gjatë tërë përshkrimit si shpërlarje e parave të pista, të cilat logjikisht do të duhej të rridhnin nga veprimtaria kriminale. Andaj, në këtë rast nuk ekziston fare përgjegjësia penale, pavarësisht nga fakti se në këtë rast përgjegjësia penale tentohet të konstatohet në mënyrë të tërthortë duke mos dëshmuar me prova por duke e konstatuar se me gjasë i mbrojturi i tij ka pas dijeni më shumë. Mbrojtësi i të akuzuarit M.S.-av.Florent Latifaj, në ankesë thekson se përgjegjësia penale është gjithmonë individuale dhe ajo nuk mund të nxirret nga veprimet e personit tjetër. Më tutje në ankesë thekson se aktgjykimi më shumë i referohet fakteve të transaksioneve bankare dhe se në bazë të përshkrimit gjykata kërkon nga i mbrojturi i tij të dëshmoj parat e transferuara në bankë janë para të pista.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e mbrojtëse e të akuzuarve F. e M.S. janë të pabazuara, meqenëse nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë asnjë provë apo ndonjë rrethanë që përjashton përgjegjësin penale e të akuzuarve. Të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale ishin të vetëdijshëm për veprimet e veta ndërsa dijenia si element subjektiv i veprës penale rezulton nga rrethanat faktike për të cilat gjykata do të elaboron në vazhdim të arsytimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka aplikuar drejt ligjin penal, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete, si në fq.18, duke qenë se nga vlerësimi i provave të administruara e në lidhshmëri me njëra tjetrën ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurve manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, në bashkëkryerje, Shpërlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, dhe neni 56 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Terrorizmit lidhur me neni 31 të KPRK-së, meqenëse të pandehurit ju kanë ndihmuar që ti transferojnë ose përpiqen të konvertojnë ose të transferojnë pasurinë-parat, me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë-parasë, me qëllim të përfitimit për vete dhe për të pandehurit aksionar tjerë të kompanisë për të kryer veprën penale të lartcekur, andaj edhe cilësimi juridik i veprës penale është dashur të bëhet në harmoni me ligjin penal në fuqi Nr. 05/L-096, për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, respektivisht neni 56 të këtij ligji.

Pretendimet e mbrojtjes dhe gjetjet e gjykatës përkitazi me vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.S.-av.Faton Qirezi, pretendon se asnjëherë nuk është vërtetuar se ka pasur pastrim parash, e aq më pak se i mbrojturi i tij ka qenë në dijeni se parat e transferuara nga shtetet e ndryshme, e të cilave i referohet prokurori i rastit, më se 90 transaksione, kanë qenë para që burojnë nga aktiviteti kriminal. Për më tepër nga aktgjykimi fare nuk mund të kuptohet se nga cila vepër penale konkretisht kanë rrjedhur paratë e transferuara, sepse as ky fakt nuk është vërtetuar. Mbi të gjitha gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i mbrojturi i tij as që ka qenë në dijeni për faktin se kanë ndodhur transferet, kurse në dispozitiv të aktgjyimit, fq.2 paragrafi i parë dhe faqe 18 paragrafi 3, gabimisht ka theksuar se të akuzuarit “e kanë bartur apo transferuar”, fq.2, apo se “kanë ndihmuar që t’i transferojnë”, fq.18. shumën e pranuar në kompaninë tjetër në Danimarkë, kur gjatë procesit gjyqësor është vërtetuar qartë se i mbrojturi im fare nuk ka marrë pjesë në transfere të parave për apo nga kompania “N...”, pasi që as që ka qenë fare i autorizuar të ndërmarrë veprime të tilla financiare në kuadër të kompanisë dhe madje as që ka pasur dijeni se transfere të tilla kanë ndodhur, duke shtuar se lidhur me veprimet e pretenduara për të mbrojturin e tij fare nuk është vërtetuar gjendja e saktë faktike, si paraqitet më lartë në fq.2 dhe fq.18 të aktgjyimit të ankimuar, gjegjësisht a ka transferuar apo ka ndihmuar të transferohen paratë. Më tej shton rreth thënieve të ekspertit në ekspertizë lidhur me të kaluarën kriminale të partnereve të huaj biznesor.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.S.-av.Florent Latifaj, thekson se i mbrojturi i tij gjatë marrjes në pyetje ka deklaruar shumë qartë se së bashku me F.S.n dhe dy personat e tjerë K.R. dhe D.L. kanë hapur një kompani në Kosovë me emrin “N...” dhe më pastaj edhe llogarinë në emër të kësaj kompanie me qëllim për të bërë biznes, dhe që të katërtit kanë pranuar të hynë në bashkëpunim biznesor ku përfitimi do të ishte 25% për secilin, dhe qëllimi i këtij biznesi ka qenë tregtia me metale të çmuara, shërbime edukimi, tregtia me vegla të makinerive, etj., dhe qëllimi i hapjes së biznesit në Kosovë nga K.R. dhe D.L. ka qenë ngase tatimi në Kosovë ka qenë më i ulët, ndërsa i mbrojturi i tij në bazë të kontratës ka pasur për detyrë vetëm të menaxhojë mjetet. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i mbrojturi i tij as që ka qenë në dijeni për faktin se kanë ndodhur transferet, duke shtuar më tej dhe cituar dispozitivin e aktgjyimit, fq.2 dhe fq.18 paragrafi 3, ku

gjatë procesit gjyqësor është vërtetuar qartë se i mbrojturi i tij nuk ka marrë pjesë në transfere të parave për apo nga kompania “N...”, pasi që as që ka qenë fare i autorizuar të ndërmarrë veprime të tilla financiare në kuadër të kompanisë madje as që ka pasur dijeni se transferet të tilla kanë ndodhur. Më tej shton se nuk është vërtetuar gjendja e saktë faktike, si paraqitet si më lartë në fq.2 dhe fq.18 të aktgjykimit të ankimuar, gjegjësisht a ka transferuar apo ka ndihmuar të transferohen paratë. Më tej shton rreth thënieve të ekspertit në ekspertizë lidhur me të kaluarën kriminale të partnereve të huaj biznesor.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësve e të akuzuarve janë të pabazuara kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta se me cilat provat ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitivë të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike e ka bazuar në provat e administruara dhe atë Raportin nr. 201706BS0055 i datës 01.08.2017 të përpiluar nga Njësi i Inteligjencës Financiare në Prishtinë, transaksionet bankare për subjektin afarist “N...”, për periudhën 01.01.2016 deri më 19.07.2017, Raportin mbi të dhënat Financiare të datës 15.09.2017, njoftimi paralajmërues për “O...” i datës 29.05.2017, të lëshuar nga Zyra e Komisionit të Shërbimeve Financiare Ndërkombëtare në Belize me të cilin vërtetohet se Kompania “O...” është duke kryer shërbimet duke mos poseduar fare licencë nga Komisioni i Shërbimeve Financiare Ndërkombëtare apo ndonjë autoritet kompetent shtetëror në Belize për të kryer çfarëdo lloji biznesi tregtar dhe është kërkuar që i njëjti të ndërpres aktivitetin e paligjshëm, faturat nr. 16457 e datës 01.05.2017, nr.16608 e datës 24.05.2017, nr. 16912 e datës 25.07.2017, me të cilat janë bërë pagesa fiktive duke mos kryer asnjë lloj tregtie apo shërbimi, ekspertiza financiare e datës 19.12.2017 nga eksperti Q.H. dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Frederiksberg nr. 3334/14 i datës 13.04.2015. Gjykata e Apelit vëren se mbrojtja e të akuzuarve gjendjen faktike e konteston për shkak se Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk i referohet asnjë prove për të dëshmuar se parat e transferuara në bankë në Kosovë janë fituar nga aktiviteti kriminal në një shtet tjetër gjegjësisht nga aktiviteti kriminal i të pandehurve K.R. dhe D.L., duke shtuar se kush i ka cilësuar para të pista dhe si dhe me çfarë provash. Lidhur me këtë fakt mbrojtja konsideron se te shmangia nga tatimi kemi të bëjmë me para të pastra por për të cilat nuk është paguar tatimi në shumën e cila përcakton shteti përkatës. Nga këto pretendime kjo Gjykatë vëren se mbrojtja nuk kundërshton ndonjë provë konkrete mbi të cilat gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin e ankimuar por vetëm dijeninë e të akuzuarve lidhur me këto para të transferuara dhe faktin se kush dhe me cilën provë është vërtetuar se nga shmangia e tatimit kemi të bëjmë me para të pista.

Gjykata e Apelit pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore të akuzuarve F.S.-av.Faton Qirezi dhe M.S.-av.Florent Latifaj, gjeti se këto pretendime ankimore janë të pabazuara, kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë sa i përket vërtetimit të faktit vendimtarë përkritazi me atë se “për ekzistimin e veprës penale të shpërlarjes së parës duhet që parat që shpërlahen të rrjedhë nga një aktiviteti kriminal gjegjësisht si rezultat i një vepre penale”, ky fakt vërtetohet me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Frederiksberg në Danimarkë, të datës 13.04.2015 me të cilin K.R. ishte shpallur fajtor për veprën penale të Shmangies nga Tatimi në shtetin e Danimarkës dhe ai është një nga aksionar të firmës “N...”, nëpërmjet të cilës me

qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës apo burimit të kësaj pasurie kanë transferuar pasurinmjetet monetare nëpërmjet xhirollogarisë së kësaj kompanie në xhirollogari e kompanisë “SCU” në Danimarkë dhe atë shumën prej 742.218.00 euro dhe 10.620.00 euro pronarë i së cilës është D. Lindberg kurse ka ngelur i pa realizuar transferi i parave në vlerë 948.820.84 euro e cila është dashur të transferohet në kompaninë “O...” në Belize, por që kjo shumë është ngrirë.

Gjykata e Apelit vëren se nuk është kontestues fakti i transaksioneve bankare të dëshmuar me kartelën bankare të R.... në Kosovës për kompaninë “N...” në shumë të përgjithshme prej 1.823.413,46 euro. Gjithashtu, fakti se kompania “N...”, pavarësisht disa aktiviteteve që i ka pas të regjistruara si biznes të gjithë transaksionet që janë lexuar në kartelën financiare nuk ka pasur dokumentacion mbështetës, pra kontrata, fatura, fletë dërgesa të cilat parashihen ti përcjellin transaksionet ekonomike financiare dhe nuk janë mbajtur librat sipas shkresave, e ky fakt është vërtetuar nga ekspertiza financiare e ekspertit financiar Q.H. e datës 15.10.2018, të mbështetur edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.10.2018, ndërsa në pajtim të palëve në procedurë është lexuar gjatë seancës gjyqësore në rigjykim. Po ashtu nuk rezulton kontestues fakti se me faturë-furnizimi me diamante në vlerë prej 742.218.00 euro paguar më 24.05.2017 në emër të kompanisë “S...” me seli në Danimarkë, rezulton të jetë D.L. i cili njëkohësisht është edhe aksionar në kompaninë “N...” në Kosovë, si dhe 1 pagesë në emër të komisionit për shitblerje në vlerë prej 10.620.00 në llogari të kompanisë “S...”, e të cilat diamante (ingoc-rruza ari) në mbrojtjen e tij i akuzuari M.S., konfirmon se nuk i kishin transportuar asnjëherë në Kosovë. Sikur që është një faturë dalëse për kompaninë “O...” me seli në Belize në vlerë prej 850.000,00 euro, për të cilin subjekt afarist nga Zyra e Komisionit të Shërbimeve Financiare Ndërkombëtare të Belizesë me seli në Belmopan, është njoftuar për veprimtarin e paligjshme të këtij subjekti i cili është duke vepruar pa licencë përkatëse në këtë shtet.

Gjykata e Apelit, e gjen si të pabazuar pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk ka arsyetuar elementin subjektiv-dashjen e të akuzuarve për kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor, kjo për faktin se si rezulton nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në faqen 10 dhe 12 ku arsyetohet aspekti i dijenisë së të akuzuarve lidhur me rrethanat e veprimit të tyre, të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykate, megjithatë kjo gjykate i vlerëson edhe disa rrethana faktike të cilat padyshim vërtetojnë se të akuzuarit ishin në dijeni dhe vepruan me qëllim të përfitimit pasuror si për vete ashtu dhe për personat e tjerë gjegjësisht D.L. dhe K.R.. Nga mbrojtja e të akuzuarit F. vërtetohet fakti se ai ka firmën e tij personale “F. Diamant Gold”, e cila meret me metalet e çmuara, si ari, platin, diamant dhe gur të çmuar. Me të akuzuarin M.S. njihen në mes veti gjegjësisht janë djemtë e mixhës. Po ashtu edhe me D.L. njihet pasi që ai kishte një firmë me të njëjtin emër, pra, “N... DTF”, e cila merrej me riciklimin e arit të vjetër dhe se aty ka punuar deri në vitin 2013. Ndërsa gjatë vitit 2014 e deri më 2016 kanë qenë bashkëpronarë në biznesin e tyre, dhe për zhvillimin e veprimtarisë së tij në veçanti bashkëpunon me firmën nga Danimarka “S...” pronar i së cilës është D.L.. Po ashtu edhe K.R. e njeh përmes D..., me të cilët kanë ardhur në Kosovë me qëllim që si bashkëpronar të bëjnë hapjen e kompanisë “N...” me arsye se në Kosovë paguhet më pak tatim se në shtet e tjera të Evropës. I akuzuari M.S. në mbrojtjen e tij vërteton faktin se përpos të akuzuarit F. të cilin e ka djalë të axhës edhe me D.L. dhe K.R. njihet pasi që ata në muajin Shkurt

të vitit 2017 ishin në Kosovë, e me të cilët si bashkëpronar kanë regjistruar biznesin “N...” me seli në Prishtinë.

Nga këto rrethana pa dyshim vërtetohet fakti se që të gjithë njiheshin në mes veti qysh para themelimit të kompanisë “N...” dhe se ata kishin dijeninë për veprimtarin e njëri-tjetrit e në veçanti i akuzuari F. me D.L. dhe K.R. kishin bërë tani më biznesin me shitblerjen e metaleve të çmuara, pra ari, etj., dhe se qëllimi i tyre ishte pikërisht që nëpërmjet biznesit “N...” me seli në Prishtinë të bënin përfitimin për vete dhe për të tjerë, e ky fakt nuk mohohet as nga të akuzuarit të cilët në mbrojtjen e vet kanë vërtetuar se si aksionar të kësaj kompanie me nga 25% të aksioneve do të përfitonin jo më pak se 10.000 euro në muaj, dhe se që të dy të akuzuarit pranojnë se nga kompania “N...” kishin tërhequr shumën prej 3.000 euro.

Nga mbrojtja e të akuzuarit F.S. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.01.2019 pranë së cilës ka mbetur edhe në seancën e rigjykimit të datës 24.11.2021 vërtetohet fakti se ideja e hapjes së firmës “N...” në Kosovë ishte e të akuzuari F. dhe aksionarit D.. Ndërsa të akuzuarin M. e ka marr si ndihmës i akuzuari F., ndërsa D.i e ka marr K. si bashkë aksionar në firmën “N...” në Kosovë dhe se ashtu si i referohet i akuzuari F. “kokat e firmës” kanë qenë D.i dhe Kimi të cilët kanë investuar më shumë në këtë firmë. Nga mbrojtja e të akuzuarit M.S. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.01.2019 pranë së cilës ka mbetur edhe në seancën gjyqësore në rigjykimit të datës 24.11.2021, vërtetohet fakti se i akuzuari F. e ka njoftuar me D.in dhe K. dhe interesimi i tyre ishte me hap një kompani në Kosovë me emrin “N...” që si veprimtari të bëjnë hulumtimin për miniera dhe minerale. Ai ishte menaxher i firmës “N...” dhe xhirollogarinë e kishin në R... në Kosovë dhe D. ka qenë i autorizuar për të bërë transaksione online. Konfirmon faktin e sjelljes së kontratës së shkruar e të nënshkruar nga të gjithë ata ndërsa ai ishte përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit sa i përket territorit të Kosovës. Konfirmon faktin se ka shkuar në R.... personalisht për të pyetur lidhur me pengesat për shërbimet online të pagesave, pasi që i akuzuari F. e ka ftuar nga Danimarka dhe i ka thënë se xhirollogaria nuk është ka funksion se është ka punohet ONLINE dhe aty ka kërkuar edhe kartelat e qarkullimit të bankës-pasqyrën bankare dhe atëherë i thash a ka mundësi me provua prej llogarisë “N...” i kam bartur në llogarinë time private diku 3.000 euro dhe ka funksionuar, e pas rastit nuk ka funksionuar më asnjë.

Nga këto rrethana pa dyshim vërtetohet se që të dy të akuzuarit, pra i akuzuari F. edhe i akuzuari M. ishin në dijeni se të gjitha transaksionet për “N...” janë duke u kryer në mënyrë ONLINE kjo pasi që nga mbrojtja e tyre vërtetohet se i akuzuari F. i kërkon të akuzuarit M. të shkoj në bankë që të shoh se pse ka pengesa në realizimin e pagesave online, e të cilat sipas tyre ishte i autorizuar që ti bënte i pandehuri-aksionari D.i, dhe me këtë rast pa dyshim vërtetohet se ai ishte në dijeni shumë të mirë që transaksionet janë duke i kryer të gjitha në mënyrë ONLINE nga aksionar të tjerë e kjo vërtetohet edhe ndërmarrja e veprimit për të provuar dhe zhbllokuar pagesat nga xhirollogaria e kompanisë “N...” në xhirollogarinë e tij duke bartur mjetet monetare në shumë prej 3.000 euro, e në anën tjetër vet i akuzuari ishte menaxher i kompanisë “N...” i cili ishte i autorizuar që edhe ai të ketë qasje në xhirollogarinë e kësaj kompanie e aq më parë se ai kishte edhe obligim që të kujdeset edhe për menaxhimin e pasurisë së kësaj kompanie mirëpo, përkundër kësaj ai me dije të plotë nëpërmjet kësaj kompanie të cilën e kishte hap ai në Kosovë i ndihmon të pandehurve tjerë që të mjetet monetare ti bartin nëpërmjet xhirollogarisë së kësaj kompanie “N...”, të cilat fillimisht përfshin një numër të transaksioneve në këtë kompani e më

pas me qëllim të fshehjes së prejardhjes së këtyre mjeteve i blejnë metalet e çmuara në kompaninë “S...”, pronar i së cilës është D.i aksionar i kompanisë “N...”, e për të cilin ishte duke punuar edhe K.R..

Nga të gjitha këto rrethana, ashtu si kishte vërtetuar edhe gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, për të cilat si të tilla edhe kjo Gjykatë i pranon e të cilat të qojnë në të vetmin përfundim se të akuzuarit F. e M. S. kanë pasur arsye shumë të fortë për ta ditur se pasuria e qarkulluar nëpërmjet xhirollogarisë së kompanisë “N...” në Kosovë buronte nga aktiviteti kriminal dhe se qëllimi i tyre ishte për të përfituar për vete dhe personat tjerë gjegjësisht bashkë aksionar të kësaj kompanie, duke i ndihmuar dhe lehtësuar bashkë aksionarëve që të konvertojnë, transferojnë ose të përipiqen të konvertojnë ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë andaj, nga të gjitha këto rrethana faktike rezulton se të akuzuarit ishin në dijeni të plotë, pasi që për këtë kishin arsye shumë të fortë për të ditur për qëllimet e hapjes së kësaj kompanie në Kosovë dhe qëllimin e tyre për ti shpërlarë paratë e fituara nga aktiviteti kriminal i aksionareve në këtë kompani mu për faktin se nga mbrojtja e të akuzuarve pa dyshim vërtetohet për dijeninë e tyre për aktivitetin bashkë aksionarëve tjerë K. dhe D., pasi që ata kanë pasur dijeni se të njëjtit do të transferojnë të gjitha mjetet monetare nëpërmjet transfereve e-banking- online, ndërsa për këtë ata do të fitojnë për çdo muaj jo më pak se 10.000 euro, dhe se për veprimtarin e kompanisë për të cilën kanë themeluar asnjëherë dhe me asnjë dokumentacion të nevojshëm nuk kanë shoqëruar këto transaksione me shumat mjaftë të mëdha e as që është sjell metalet e çmuara në Kosovë.

Marrë parasysh faktin se, sipas mbrojtjes së të akuzuarve, aktiviteti i kësaj kompanie “N...” në Kosovë, ishte që të hulumtonin minierat dhe mineralet-metale e çmuara në Kosovë, rezulton se kjo fare nuk ishte ashtu pasi që nga mbrojtja dhe transaksionet rezulton se nëpërmjet xhirollogarisë “N...” janë blerë metalet të çmuara në kompaninë “S...” në Danimarkë, pronar i së cilës është vet D.L. që ishte edhe bashkë aksionar në kompaninë “N...” në Kosovë, andaj është jashtë logjikes se pse do të blinte prej vetës një gjë të cilën tani më e kishte në pronësi dhe posedim përveç se nëpërmjet këtyre transaksioneve të vë në deponim paratë nëpërmjet llogaris bankare që nëpërmjet kësaj forme të bëjë shpërlarjen e parave të fituara nëpërmjet aktivitetit kriminal.

Në anën tjetër nëse ata do të realizonin me të vërtet qëllimin e hulumtimit të metaleve të çmuara në Kosovë pse do të blinin nga kompania e tij metalet e çmuar në Danimarkë të cilat nuk i kishin sjell asnjëherë në Kosovë, pra nga e gjitha kjo nuk mund të nxirret asnjë përfundim tjetër përpos që nëpërmjet kompanisë “N...” në Kosovë, me ndihmën e të akuzuarve F. e M.S. të kryejnë transaksionet e mjeteve monetare me qëllim të shpërlajres së parasë, për të cilën vepër penale janë shpallur fajtor me aktgjykimin e ankimuar e që në tersi pajtohet edhe kjo Gjykatë se në veprimet e të akuzuarve F. e M.S. formohen të gjitha elementet e veprës penale të shpërlarjes së parasë nga neni 308 dhe nenit 56 par. 1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit mbi parandalimin e shpërlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit pas analizimit dhe vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar së bashku me shkresat tjera të lëndës mbështet në tersi përfundimin e drejt dhe ligjor të gjykatës së shkallës së parë për vërtetimin e drejt dhe të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjen e të akuzuarve penalisht përgjegjës

për veprimet e tyre për kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe arsye të dhëna në këtë drejtim për aplikimin e ligjit Nr.05/L-096 gjegjësisht nenin 56 të Ligjit për Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e Gjykatës përkitazi me dënimin.

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në ankesë pretendon se me rastin e matjes së dënimit Gjykata nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat rënduese, edhe pse gjykata vlerësoi se të pandehurit e lartcekur veprën e kanë kryer me dashje direkte, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, kontributin esencial në kryerje të veprës penale, mirëpo pasi që për këtë vepër penale parashihet dënim me burgim deri në 10 vjet dhe me gjobë deri në 3 herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, konsideron se dënimi i shqiptuar nuk është adekuat me shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit për veprën penale dhe me dënime të tilla nuk mund të pritet që realizohet qëllimi i dënimit që është paraparë në neni 41 të KPRK-së.

Mbrojtësit e të akuzuarve F. e M.S. edhe pse me ankesë e kanë ankimuar aktgjykimin e shkallës së parë edhe mbi bazën e vendimit mbi dënimin në ankesë nuk cekin asnjë pretendim lidhur me këtë pikë të ankesës por vetëm e kontestojnë vendimin mbi dënimin pasi që vërtetimi i fakteve është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe se në këtë rast nuk ekziston përgjegjësia penale dhe nuk është dashur të ketë aktgjykim dënues.

Gjykata e Apelit konstaton se në rastin konkretë, edhe përkundër pretendimeve ankimore të Prokurorisë Speciale, marrë parasysh se si rezultat i mjeti i jashtëzakonshëm juridik të parashtruar nga mbrojtja e të akuzuarve e të aprovuar nga Gjykata Supreme, tani aktgjykimi i ankimuar nuk mund të ndryshohet në dëm të tyre ngase një e drejtë e tillë i garantohet sipas ndalesë ligjore Reformatio in Peius të paraparë sipas nenit 395 të KPPRK-së e cila pozitivisht sigurohet nga parashtrimi i mjetit të vetë juridik, por jo edhe në rastet kur mjeti juridik paraqitet nga pala e kundërt.

Ndërsa nga ana tjetër edhe përkundër se mbrojtja e të akuzuarve ka paraqitur ankesën edhe mbi bazën ankimore të vendimit mbi dënimin, në fakt në ankesat e tyre nuk kanë theksuar dhe paraqitur asnjë pretendim në raport me vendimin mbi dënimin duke cekur ndonjë rrethanë për të cilën gjykata nuk ka marrë parasysh gjatë shqiptimit të sanksionit penal apo të dënimit plotësues të konfiskimit të shumave të parave, andaj duke marrë parasysh arsyet të cilat i ka gjetur dhe vlerësuar Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, edhe kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara janë në funksion të parandalimit të kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të ndikojnë në rehabilitimin e tyre dhe të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe se me këtë dënim të shqiptuar të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në neni 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

**GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr. 6/2022, më datë.23.06.2022**

Bashkëpunëtorit profesional

Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit

Vaton Durguti

Tomislav Petrovic

Kryetari i kolegjit,

Kreshnik Radoniqi
